


Si të ankimoni një vendim të Departamentit të Punës dhe Industrisë në kërkesën tuaj



Çfarë është ankimimi?

Ankimimi është një letër ku ju shprehni se nuk pajtoheni me një vendim mbi kërkesën tuaj për kompensim si punëtor. Ankimimi duhet të merret brenda 60 ditëve nga marrja e vendimit.

Ankimimi duhet të përfshijë:

- Emrin tuaj dhe numrin e kërkesës.
- Datën e vendimit të departamentit.
- Arsye pse nuk pajtoheni plus çdo raport të ofruesve të kujdesit ose informacion tjetër që ju besoni se tregon se vendimi është i gabuar.

Ku duhet ta dërgoj ankimimin ose apelimin tim?

- Dërgoni ankimim nëpërmjet internetit duke përdorur Claim and Account Center (Qendra e Kërkesave dhe Llogarive) në <https://secure.Lni.wa.gov> (do t'ju duhet të konfiguroni një llogari me fjalëkalim për ta përdorur këtë opsion). OSE
- Dërgoni ankimim me shkrim te: Department of Labor & Industries, P.O. Box 44291, Olympia WA 98504-4291. OSE
- Dërgoni një apelim me shkrim në adresë të Board of Industrial Insurance Appeals (BIIA), Executive Secretary, P.O. Box 42401, Olympia WA 98504-2401, ose dërgojeni apelimin tuaj në një formular elektronik që gjendet në adresën www.BIIA.wa.gov. (Labor and Industries [Departamenti i Punës dhe Industrisë] mund të mos jetë në gjendje t'u përgjigjet shqetësimeve tuaja në rast se Bordi i Apelineve të Sigurimeve Industriale [Board of Industrial Insurance Appeals, BIIA] nuk e urdhëron të veprojë kështu.)

Çfarë ndodh kur departamenti merr ankimimin?

Punonjësi të cilit i ngarkohet kërkesa juaj do ta shqyrtojë atë dhe do të kryejë një prej veprimeve të mëposhtme:

1. Ndryshon vendimin e parë. Ju do të merrni një letër ose urdhër të ri, ose të dyja, me vendimin e ri.
2. Vendos se vendimi i parë është i drejtë. Do të merrni një urdhër ku thuhet se vendimi ishte i drejtë. Mund të apeloni me shkrim kundër këtij urdhri të ri duke i shkruar Bordit të Apelineve të Sigurimeve Industriale (BIIA) nëse sërish nuk pajtoheni. Periudha kohore dhe adresa e postimit për apelimin jepen në urdhrin e marrë.

3. Vendos se nevojitet më shumë informacion. Ju do të merrni një urdhër i cili e lë vendimin në pritje, një letër ku kërkohet më shumë informacion, ose të dyja. Punonjësi të cilit i ngarkohet kërkesa juaj mund të kërkojë më shumë informacion prej jush, mjekut tuaj apo punëdhënësit tuaj.

Vendimi në lidhje me ankimimin tuaj mund të kërkojë 30 deri 60 ditë, ose më shumë, në varësi të nevojës ose jo për informacion të mëtejshëm. Nëse nuk keni marrë përgjigje brenda 30 ditëve pas dërgimit të ankimimit, ju lutemi kontaktoni me punonjësin të cilit i është ngarkuar kërkesa juaj.

Çfarë ndodh nëse nuk dërgoj ankimim apo apelim, ose nëse e bëj këtë pas 60 ditësh?

Nëse nuk dërgoni ankimim apo apelim brenda periudhës prej 60 ditësh, vendimi i departamentit bëhet i formës së prerë. Kjo do të thotë se nuk mund të dërgoni ankimim apo apelim pas kësaj date.

Nëse kam pyetje apo shqetësime në lidhje me kërkesën time, me kë duhet të kontaktoj?

- Punonjësin që shqyrton kërkesën tuaj për pyetje specifike në lidhje me kërkesën. Punonjësi i ngarkuar me kërkesën tuaj ka mundësinë që të përdorë përkthyes për ta ndihmuar me telefonatën.
- Për informacion të përgjithshëm në lidhje me kërkesën numrin falas të departamentit, 1-800-547-8367. Ky numër ka një opsion për ta dëgjuar informacionin në spanjisht.

Për ndihmë të mëtejshme, mund të konsultoheni me shërbimet e mëposhtme falas:

- Project Help (Projekti Ndhima) në numrin 1-800-255-9752. Mund të nevojitet shërbimi i një përkthyesi.
- Edukimi, Arsimi dhe Rekomandimi i Koordinuar Ligjor (Coordinated Legal Education, Advice and Referral, CLEAR) në numrin 1-888-201-1014. Ky shërbim ofron këshilla dhe rekomandime për punonjësit me të ardhura të ulëta gjatë ditëve të javës, në orarin 09:15-12:15. Informacioni disponohet edhe në spanjisht.

Kontaktimi me Projektin Ndhima ose me CLEAR nuk përbën ankimim apo apelim ndaj vendimit të departamentit. Për të kundërshtuar një vendim të departamentit, ndiqni hapat e përcaktuara në këtë fletë faktesh.

PUBLICATION F242-363-200 (Albanian) [04-2019]



Washington State Department of
Labor & Industries

Workers' Compensation Services

Formatet e tjera për personat me aftësi të kufizuara jepen me kërkesë të të interesuarve. Telefononi në 1-800-547-8367. Përdoruesit e TDD, telefononi në 360-902-5797. L&I (Departamenti i Punës dhe Industrisë) është punëdhënësi me mundësi të barabarta.